

## SHKALLËT E BESIMTARËVE NË RRUGËTIMIN DREJT ALLAHUT (MEDAARIXH ES-SAALIIN)

---

### Kujdesi / *er-Riaajeh* / الرعاية

Dr. Hatim el-Haxh

Materiali është përmbledhje e kuptimeve të audio-ligjëratës nga nxënësit e hoxhës

<https://buff.ly/2hbVv4T>

### Seksioni i ndërveprimeve (المعاملات)

Ky seksion përbëhet nga dhjetë kapituj: Kujdesi, Vigjilenca, Shenjtërimi, Devocioni, Rafinimi, Ndershmëria, Mbështetja, Delegimi, Besimi, dhe Nënshtrimi

Allahu ﷻ thotë:

"فَمَا رَعَوْهَا حَقَّ رِعَايَتِهَا"

"... por ata nuk u kujdesën për të (murgërinë) ashtu si duhej."<sup>1</sup> (el-Hadid, 27)

Kujdesi ka të bëjë me ruajtjen (e të çmuarës) me zell. Kjo ka tri nivele. Niveli i parë është kujdesi për veprat. Niveli i dytë është kujdesi për gjendjet. Niveli i tretë është kujdesi për kohën.

Kujdesi për veprat nënkupton:

- Zhvillimin e tyre duke i nënçmuar<sup>2</sup>
- Bërjen e tyre pa i shikuar (pa i vënë re)<sup>3</sup> dhe
- në përputhje me dijen (për kushtet e veprave), jo për zbulurim të vetvetes

---

<sup>1</sup> Imam ibn el-Kajjim përmend në *Medaarixh es-Saaliin* se ata (të krishterët) qenë fajësuar, për shkak se nuk u kujdesën për një veprim që ua kishin obliguar vetëve të tyre. Dhe më keq se kjo është të mos kujdesesh për një veprim që të ka obliguar Allahu.

<sup>2</sup> Për sa kohë që t'i shohësh adhurimet e tua si tepër të vogla për të qenë të denja për bujarinë e Zotit tënd, ato do të vazhdojnë të rriten.

<sup>3</sup> Ti s'bën t'i shohësh veprat e tua; barrën, sasinë, dhe përsosurinë e tyre. Shikimi yt duhet të ngulitet në Zotin të cilit i kushtohen ato. Veprat mund të bëhen një perde që pengojnë shikimin tënd, nëse nuk shikon tejprtej tyre dhe matanë tyre.

Kujdesi për gjendjet nënkupton që të konsiderosh se:

- Shquarja me to do të thotë t'i bësh sa për sy e faqe
- Njëmendësia e gjendjes është e pabazë<sup>4</sup>
- Gjendja (*haal*) është thjesht vetëm një deklaram<sup>5</sup>

Kujdesi për kohën nënkupton:

- Pauzë në çdo hap<sup>6</sup>
- Pastaj shkëputje nga hapat duke dëlir zemrën nga egoja<sup>7</sup>
- Dhe në fund përmbajtje nga të parët e dëlirësisë sate<sup>8</sup>

---

<sup>4</sup> Ai (autori) ose mendoi se duhet dyshuar në bindjen tënde për gjendjen dhe të mundohesh të bësh më shumë, ose mendoi se njëmendësia e gjendjes s'është gjë tjetër veçse një dhuratë nga Allahu të cilën ti s'duhet ta pohosh si diçka tënden.

<sup>5</sup> Në çfarëdo qoftë gjendje që të jesh, ti duhet të dyshosh ekzistencën tënde në atë gjendje (*haal*) apo stacion (*mekaam*); ato (vepra) mund të jenë iluzione të cilat ti ki qejf t'i besosh si të vërteta.

<sup>6</sup> Për ta parë çfarë nijeti ke, për t'i korigjuar veprimet e për t'i përsosur me *ihsaan*.

<sup>7</sup> Pasi të kalosh kohë duke parë të përsosen veprat e tua, duhet të shikosh përtej kësaj, në mënyrë që kjo të mos bëhet shkak për mburrësi.

<sup>8</sup> Pasi të kesh pastruar zemrën nga ndyrësira e mburrësisë, nga vetëbesimi i tepërt e nga të gjitha helmet e tjera, ti nuk bën ta pranosh atë dëlirësi, sepse atëherë mund të marrësh në thua mu në të dhe të dështosh në arritjen e synimit: të jesh me Allahun dhe të mos shohësh gjë tjetër veç Tij.